

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

VOTIMI JASHTË VENDIT DHE SFIDAT E
ZGJEDHJEVE TË VITIT 2025

LM. Reald KETA



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

LM. Reald KETA

VITI I PUBLIKIMIT

janar 2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Praktikat gjyqësore	04
Diskutimi i munguar	05
Praktika zgjedhore	06
Rasti i Mbretërisë së Bashkuar	08
Përfundime	09
REFERENCA	10

Të votuarit tradicionalisht përbën të shkuarin e votuesit në Qendrën e Votimit respektive, të shenjuarit e fletës në Dhomën e Fshehtë në ambientet e qendrës dhe më pas vendosjen e fletës në kutinë e votimit. Me modernizimin e proceseve kjo panoramë nuk është aq tradicionale për shkak të formave alternative të parashikuara me qëllim lehtësimin maksimal për çdo qytetar për të ushtruar të drejtën e votës dhe të proceseve të tjera të lidhura, si numërimi apo shpallja e rezultatit. Format alternative të praktikuar parashikojnë që prej formës më të hershme me funksionimin e Komisioneve të Lëvizshme që transportojnë kutinë pranë banesave të qytetarëve, duke vazhduar me votimin nëpërmjet shërbimit postar e deri tek i votuari nëpërmjet internetit.

Një prej rrethanave ku lind nevoja e krijimit të mundësive për të votuar dhe të eliminimit të vështirësive në ushtrimin e të drejtës së votës, është të votuarit e shtetasve që janë me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm larg vendit të origjinës në Ditën e Zgjedhjeve. Diskutimi mbi të drejtën e votës në distancë të këtyre shtetasve, në realitetin shqiptar ka qenë një shoqërues i vazhdueshëm i proceseve zgjedhore dhe në dekadën e fundit ka qenë gjithmonë e më i zëshëm.

Shtetasit shqiptarë që Ditën e Zgjedhjeve ndodhen jashtë territorit të Republikës gabimisht barazvlerësohen me bashkësinë e së ashtuquajturës diasporë. Bashkësi që në Kosovë njihet ndryshe me emërtimin mërgatë. Referim që është thjeshtëzues dhe nuk ndihmon në trajtimin e rregullt të çështjes. Për këtë arsye, në vazhdim të dokumentit, për lehtësi komunikimi, të votuarit e shtetasve që janë me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm larg vendit të origjinës në Ditën e Zgjedhjeve do të konsiderohet votimi jashtë vendit (out-of-country voting, OVC).

Në literaturën apo aktet rregullatore për çështjet zgjedhore, gjenden referime si “abroad voting, vote à l'étranger, distance voting, remote voting, external voting, absentee voting”. Terma që mund të ndërkëmbehen me njëri-tjetrin apo mbartin në raste të njëjtin kuptim me OVC, por që mbartin dhe nuanca specifike. Në vlerësimin e autorit dhe duke iu referuar burimeve respektive më të sakta, do të përdoret termi “votimi jashtë vendit”.

Për të 10 legjislaturat e votuara në zgjedhjet e përgjithshme prej vitit 1991, legjislacioni zgjedhor asnjëherë nuk ka parashikuar instrument ligjor për të votuarin jashtë vendit për shtetasit e tij. Përkundrajt kësaj, gjithmonë në amplituda të ndryshme ka patur emigrantë shqiptarë që janë kthyer në formë të organizuar ose jo, qëllimisht ose jo, për të votuar në procesin zgjedhor.

Diskutimi gjithnjë e më intensiv apo rritja e presioni publik, passolli në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme për Kuvend, mundësimin e votimit në distancë për shtetasit në fjalë. Një arritje e përgëzueshme në parim, por vlerësohet që nuk erdhi sipas një procesi të vendosur mirë, në një rrafsh ideor të qendrueshëm e të plotë.

Në këtë kontekst, për këtë artikull më së pari është shumë e nevojshme një parashtrim teorik mbi çështjen. Gabimisht diskutimi publik dhe politik është mbyllur në dikotominë e të qenurit “pro ose kundër votës së diasporës”. Padrejtësisht kjo qasje mbithjeshtëzon dhe keqtrajton çështjen, duke mos marrë në konsideratë amalgamin e nevojave që mbart diskutimi. Këto çështje do të të marrin një trajtim më të plotë në vijim të artikullit.

Praktikat Gjyqësore

Neni 3, i Protokollit Nr. 1, të Konvenës Europiane për të Drejtat e Njeriut është guri i themelit garantist në aspektin zgjedhor të lirive politike. Kjo dispozitë i detyron shtetet "të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës". Në mënyrë gati transpozuese, gjejmë të njëjtin parashikim në Dokumentin e Kopenhagenit[1].

Së pari, garancitë në fjalë nuk kërkojnë nga vendet një sistem zgjedhor të caktuar. Shtetet kanë të drejta të gjera lidhur me mënyrën sesi i organizojnë zgjedhjet, përfshirë dhe kushtet që duhet të plotësohen nga kandidatët për postet përkatëse. Referuar nenit të Protokollit, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në disa çështje ka vendosur disa standarde mbi të drejtën e votës në tërësi dhe në të drejtën e votës nga shtetasit nga jashtë.

Në rastin "Sitaropoulos e të tjerë kundër Greqisë"[2], GJEDNJ ka vendosur që mos krijimi i mundësive proceduriale apo mos krijimi i mekanizmave për votimin jashtë vendit nuk përbën shkelje të nenit në fjalë. Madje në rastin "Shindler kundër Mbretërisë së Bashkuar"[3], GJEDNJ ka pranuar që edhe vetë kufizimi i së drejtës së votës për shtetasit jashtë vendit nuk përbën cenim. Dy rrethana, që GJEDNJ i ka mbështetur në një sërë parimesh dhe argumentash.

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ ndërsa thekson rëndësinë e dhënies së të drejtave të votës për qytetarët që banojnë jashtë, ka konkluduar se kufizimi i të drejtës për të votuar për qytetarët që banojnë në territorin kombëtar

mund të justifikohet. Më përmbledhtazi, tek "Hilbe kundër Lihtenshtein"[4] gjejmë argumentet legjitimuese si:

- supozimi se një qytetar jo-rezident është më pak i lidhur drejtpërdrejt ose vazhdimisht me problemet e përditshme të vendit dhe ka më pak njohuri për to, që mund të quhet një "lidhje e dobët" me vendin e origjinës;
- pamundësia praktike dhe ndonjëherë e padëshirueshme (në disa raste edhe e pamundur) për kandidatët parlamentarë në paraqitjen e çështjeve elektorale qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, në mënyrë që të sigurohet shprehja e lirë e opinionit;
- ndikimi i qytetarëve rezidentë në përzgjedhjen e kandidatëve dhe në formulimin e programeve të tyre elektorale;
- korrelacioni midis së drejtës për të votuar në zgjedhjet parlamentare dhe të qenit i prekur drejtpërdrejt nga aktet e organeve politike të zgjedhura.

Tek "Melnychenko kundër Ukrainës"[5], GJEDNJ ka vijuar duke shprehur se rezidenca jashtë vendit e personit mund të përbëjë shkak për ta ndaluar këtë të fundit për të kandiduar për post publik. Pra e drejta e sufraghit pasiv mund të lidhet me rezidencën në një periudhë të caktuar në vendin e origjinës.

Komisioni i Venecias, në vijim edhe të praktikës së GJEDNJ, ka argumentuar se "ndërsa mohimi i të drejtës për të votuar për qytetarët që jetojnë jashtë ose vendosja e kufizimeve mbi atë të drejtë përbën një kufizim të principit të së drejtës universale, Komisioni nuk e konsideron në këtë fazë se principet e trashëgimisë zgjedhore europiane kërkojnë përcaktimin e një të drejte të tillë"[6].

Në këtë panoramë të përmbledhur në raport

pozitivist nuk gjejmë garanci si në kufizimin e votës edhe më pak në mundësimin e votës për shtetasit jashtë vendit të origjinës.

Ndryshe nga kjo tablo, Këshilli i Europës ka qenë në Europë dhe universalisht një ndër promotorët kryesorë jo vetëm të vendosjes në zbatim të votimit jashtë vendit, por dhe të ruajtjes së lidhjes politike të shtetasve me vendet e origjinës. Me anë të rekomandimeve dhe rezolutave, që prej vitit 1982 e në vijim, ka nxitur forcimin e lidhjes politike të shtetasve me vendin e tyre të origjinës.

Rekomandimi 951 (1982) i Këshillit të Europës[7] është një nga dokumentet e parë që trajtoi të drejtat e votës për shtetasit jashtë vendit. Këshilli i Europës duke referuar se ekzistonin 9 milionë shtetas me qendrim jashtë vendit të origjinës për vendet anëtare, inkurajonte vendet anëtare të Këshillit të Europës që të siguronin mekanizma të votimit për qytetarët e tyre që jetojnë jashtë vendit.

Diskutimi i munguar

Komisioni i Venecias është shprehur në disa raste për çështjen e votimit jashtë vendit. Dokumentet analitikë të Komisionit të Venecias në vijimësi ndihmojnë në të kuptuarin e zhvillimit ideologjik dhe atij praktik. Termi diasporë përpos se lehtëson komunikimin për temën, në fakt nuk është i saktë në diskutim. Jo të gjithë shtasit shqiptarë që në Ditën e Zgjedhjeve nuk gjenden në Shqipëri, nuk janë për të njëjtën arsye. Këtu mund të listohet se disa prej tyre janë të larguar për angazhime pune, disa për pushime, disa kanë krijuar një jetë të re e nuk janë kthyer asnjëherë, disa të tjerë përpos angazhimeve si të integruar në

shoqërinë pritëse vazhdojnë të jenë aktive në shoqërinë shqiptare, apo të tjera eventualitete. Mbështetur në një logjikë të thjeshtë, Komisioni i Venecias ka përcaktuar tre kategori shtetasish që Ditën e Zgjedhjeve janë fizikisht jashtë kufijve shtetërorë dhe e kanë të pamundur të votojnë.

Kategoria e parë janë qytetarët që mund të jenë jashtë vendit në ditën e zgjedhjeve për arsye biznesi ose personale. Së dyti, ka qytetarë që, për arsye akademike ose punësimi, kalojnë një periudhë të caktuar dhe të përkohshme në një vend tjetër. Së fundmi, kategoria e tretë përfshin qytetarët që banojnë jashtë për një periudhë shumë më të gjatë, të cilët ndonjëherë mund të kenë dy shtetësi dhe që vendosen në vendin pritës në një mënyrë më të përhershme[8].

Bashkësia e tretë, që gjerësisht konsiderohet “diasporë”, është kategoria që në aspektin teorik dhe praktik mbart pikëpyetje. Argumentet e dy kahëve janë të shumtë dhe në mënyrë të vazhdueshme janë ricikluar në diskursin publik. Këtu, autori në një vlerësim teorik do të evidentojë disa argumente pro dhe kundër që i vlerëson se meritojnë vëmendjen, por që nuk janë marrë sa duhet në konsideratë.

Argumente Pro

- Në vitin 2022, raportohet se reminetancat për Shqipërinë ishin në vlerën rreth 1.2 miliardë euro dhe afërsisht 10% e Prodhimit të Brendshëm Bruto[9]. Një kontribut i tillë në ekonominë vendase dhe në parimin “no taxation without representation” i jep një rol politik jo të pakët këtyre shtetasve;

- Nëse marrim në konsideratë që establishmentit politik në Shqipëri i ka munguar qarkullimi i lidershipeve, pa raste të ngjashme në vendet e Bllokut Sovjetik, ngritja e mekanizmave për përfshirjen e votuesve jashtë vendit në parim do të ndihmonte në ripërtëritjen e përfaqësimit politik;
- Referuar zhvillimeve të fundit globale, lëvizjet gjeostrategjike kanë vendosur në pikëpyetje sigurinë, për të cilën shumë vende kanë marra masa si rikthimi i shërbimit ushtarak të detyrueshëm apo ngritja e shërbimit ushtarak rezervist. Në këtë kuadër përpjekjet për të ruajtur lidhjen socio-politike me shtetasit e saj do të shërbente në marrjen e masave në raport me sigurinë kombëtare.

Argumente kundër

- Në një vlerësim paraprak, buxheti i nevojshëm për mekanizmin e votimit nga jashtë do të kërkojë një buxhet 2.5 milionë euro[1]. Jo vetëm vlera si e tillë, por edhe masa, do të duhet të krahasohet me masat e marra për shtetasit me banim brenda vendit me aftësi ndryshe apo të pamundur. Kjo masë buxhetore për të lehtësuar votimin e shtetasve jashtë do të duhet krahasuar me masat e marra për grupet e marginalizuara në vend. Si rrjedhojë, nëse përballemi me një numër shtetasish shqiptarë që për arsye financiare nuk pajisen me një dokument identifikimi, mund të gjejmë një disproporcion masash;
- Integriteti i mekanizmit është e një rëndësie absolute jo vetëm në pranimin e rezultatit zgjedhor, por edhe të ruajtjes së mekanizmit në të ardhmen. Nëse

mekanizmi do të shoqërohet me kritika, kjo mund të pasjellë tërheqjen e interesimit të shtetasve nga jashtë për të votuar, por edhe me reagimin e shtetasve brenda ose forcave politike për ta braktisur si mekanizëm.

Asnjë prej argumenteve të mësipërm, si dhe ato të njohura gjerësisht, nuk mund të konsiderohen vendimtare në të drejtën që përcaktojnë. Ato duhen kundërpeshuar në raport me aspiratat shoqërore, mundësitë infrastrukturore dhe vullnetin demokratik. Në çdo rast, zgjedhja që do të bëjë shoqëria dhe legjislatori në fund, duhet të mbështet në pritshmëri, realizimi ose mosrealizimi i të cilave do të mundësojë rishikimin në të ardhmen.

Praktika zgjedhore

Ndryshe nga panorama garantiste, në pjesën dërmuese të vendeve, lejohet në parim dhe mundësohet të votuarit e shtetasve jashtë vendit. Një panoramë që deri pak kohë më parë nuk ishte e tillë dhe jo pak vende nuk parashikonin rregullime për votimin e shtetasve jashtë vendit. Në një farë mase, mund të argumentohet që vendet e vogla dhe me emigracion masiv kanë qenë kryesisht më të vonat në parashikimin e votimit nga jashtë[11].

Mënyrat e të votuarit

Fillimisht vlen të bëhet sqarimi se votimi jashtë vendit si mekanizëm përfshin disa forma, të përdorura edhe si plotësuese të njëra-tjetrës, si vijojnë:

- ngritja e qendrave të votimit jashtë vendit;
- të votuarit me anë të shërbimit postar,
- të votuarit nëpërmjet internetit,
- të votuarit me faks;
- me përfaqësues ligjor (proxy voter).

Për vitin 2022 rezultojnë [12] që për pjesën më të madhe të vendeve, votimi jashtë vendit kryhet nëpërmjet ngritjes së qendrave të votimit jashtë vendit. Mënyrë tjetër tepër e përdorur, e renditura e dyta, vijnë vendet që parashikojnë votimin jashtë vendit me shërbimin postar.

Grafiku 1 - Përqindja sipas mënyrave të votimit nga jashtë




Hartimi dhe përgatitja e listave të zgjedhësve është një tjetër çështje e rëndësishme teknike në votimin nga jashtë vendit. Për krahasim kujtojmë se në rastin e votimit brenda Shqipërisë, hartimi i listës së zgjedhësve konsiderohet sistem pasiv. Lista e zgjedhësve gjenerohet nga baza e Gjendjes Civile dhe nga qytetarët nuk nevojitet të ndërmarrin veprime, përpos rasteve kur kanë pretendime për pasaktësi.

Në praktikën globale, rezultojnë se 87% e vendeve në rastin e votimit nga jashtë regjistrimi i votuesve është sistem aktiv. Ndërsa në 11% të vendeve, regjistrimi i votuesve është pasiv, pra votuesve nuk iu duhet të ndërmarrin veprime për t'u bërë pjesë e listës. Në këtë rast, kryesisht lista e këtyre votuesve gjenerohet mbi bazën e informacionit që ambasadat zotërojnë për këta shtetas. [13]

Zona zgjedhore

Në rastin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvend, një detaj i konsideruar teknik, por që në fakt mbart një diskutim të fortë, është caktimi i zonës zgjedhore dhe i mandateve respektive. Së pari, bëhet fjalë nëse shtetasit që votojnë jashtë vendit do të përfshihen në një zonë zgjedhore jo gjeografike (imagjinare) apo do të votojnë sipas gjendjes civile që kanë patur. Në rastin e një zone zgjedhore jo gjeografike të përcaktuar për votuesit nga jashtë, do të thotë edhe një numër mandatësh që votuesit do të përzgjedhin. Kjo ndarje nënkupton caktimin e peshës elektorale që do të marrë vota e shtetasve jashtë vendit dhe për rrjedhojë ka impakt në rezultatin zgjedhor. Në një përmbledhje të praktikës, rezultojnë se numri i këtyre mandateve nuk e kalon 4% të mandateve të trupës legislative të ulët ose të lartë.

Grafiku 2- Raporti i përfaqësuesve të diasporës



Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias ka vendosur një parim drejtues në përzgjedhjen midis dy alternativave [14]. Në rastin e shteteve ku qytetarët jetojnë jashtë në numra të mëdhenj, në masën që votat e tyre mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultatet zgjedhore, propozohet më e përshtatshme të ofrohet

parlamentar për qytetarët që banojnë jashtë me numra të paracaktuar të deputetëve të zgjedhur nga ata.

Në këtë moment lind një çështje tjetër për diskutim, që varet nga numri i votuesve nga jashtë që marrin pjesë. Nëse numri i votuesve në listë është i lartë, por pjesëmarrja është e ulët, kjo do të passillte një zbalancim në proporcionalitetin që duhet të ketë vota në raport me të gjithë mandatet. Nën parimin e barazisë së votës, pesha elektorale e të gjithë mandateve do të duhet të jetë e njëjtë.

Sillet në vëmendje, se në një qasje të përgjithshme, votuesit nga jashtë vendit janë më ulët në pjesëmarrje sesa votuesit brenda vendit. Një prej përjashtimeve të rralla që ka sjellë praktika është procesi zgjedhor i vitit 2020 në Kroaci, ku përqindja e pjesëmarrjes brenda vendit ishte 46.02% ndërsa përqindja e pjesëmarrjes së votuesve jashtë vendit ishte 99.92%[15].

Rasti i Mbretërisë së Bashkuar

Deri në vitin 1985, me përjashtim të Forcave të Armatosura dhe punonjësve të Kurorës, askush me vendbanim jashtë Mbretërisë së Bashkuar nuk mund të votonte në zgjedhjet parlamentare. Me miratimin e “Representation of the People Act”, në vitin 1985 u njoh e drejta e shtetasve me vendbanim jashtë Mbretërisë së Bashkuar sipas disa kufizimesh, që në vijueshmëri u ndryshuan. Me “Political Parties and Elections and Referendums Act”, në vitin 2000 e drejta për shtetasit me vendbanim jashtë Mbretërisë, pati rikufizim të dytë dhe u parashikua votimi me postë. Që nga ky akt, e drejta për të votuar u njihej shtetasve që kishin më pak se 15 vite vendbanim jashtë, nga 20 vite që ishte kufizimi në fuqi.

Në vitin 2024, për herë të parë të historisë së Mbretërisë së Bashkuar, çdo shtetas pavarësisht periudhës së vendbanimit jashtë vendit mund të votonte për zgjedhjet parlamentare. Heqja e kufizimit ligjor për vendbanimin jo më shumë se 15 vite jashtë MB-së, i dha të drejtën për të votuar rreth 3.5 milionë personave[16]. Një masë jo vetëm në respektim të të drejtës së votës, por dhe si një masë për të rritur pjesëmarrjen.

Ajo që ndodhi në zgjedhjet e 4 korrikut 2024 në Mbretërinë e Bashkuar përsa i përket pjesëmarrjes ishte jashtë pritshmërive. Që prej vendosjes së sufraghit universal në vitin 1928, zgjedhjet e vitit 2024 shënuan përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes me 51%. Përpos kësaj tabloje në tërësi, edhe pjesëmarrja e votuesve nga jashtë ishte e ulët në precedent historik. Nga totali i shtetasve në listën e votimit, vetëm rreth 135 mijë persona ishin shtetas të regjistruar me vendqendrim ose vendbanim jashtë, kur rekordi i vitit 2017 është 285 mijë votues të regjistruar. Rezultante që e ka shtyrë Partinë Laburiste të synojë regjistrimin automatik si votues për shtetasit jashtë vendit dhe madje të ulë moshën e të drejtës së votës.

Moria e çështjeve, sëbashku me nëntemat, që morën një trajtim më lart, ishte një përpjekje për ta zhbërë diskutimin e deri më sotëm si një qëndrim pozitiv dhe negativ ndaj asaj që konsiderohet e drejta e votës së diasporës. Zgjedhjet e ardhshme si përvojë e parë pashmangshmërisht do vuajnë nga problematikat e të qenurit herë e parë dhe si e tillë të gjithë aktorët politikë dhe jo politikë do të kenë për të mësuar shumë. Megjithatë, përvoja e parë nuk mund të lejohet të vazhdojë në shtratin e ngritur, më shumë një nyje e prerë sesa një zgjidhje e matur. Në mungesë të një debati të mirëformuar rrezikohet në rastin më të mirë që vota e shqiptarëve jashtë vendit të mos marrë peshën elektorale që meriton ose në rastin më të keq të keqpërdoret.

Është me vlerë të përmendet çështja e parë mbi liritë politike e marrë në shqyrtim nga GJEDNJ, e cila duhet kujtuar se për një kohë të gjatë ishte e “ndrojtur” në raport me këtë temë. Në çështjen “Mathieu-Mohin and Clerfayt kundër Belgjikës”[17], Gjykata argumentoi se: “Të drejtat në fjalë nuk janë absolute. Duke qenë se Neni 3 i njuh ato pa i përcaktuar në terma të shprehura, e aq më pak pa i përkufizuar, ka hapësirë për kufizime të nënkuptuara. Në rendet e tyre ligjore të brendshme, Shtetet Kontraktuese e bëjnë të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar subjekt të kushteve që në parim nuk përjashtohen nga Neni 3. Ato gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë fushë, por është Gjykata që ka fjalën e fundit për të përcaktuar nëse kërkesat e Protokollit nr. 1 janë përmbushur; ajo duhet të bindet që kushtet nuk i kufizojnë të drejtat në fjalë në atë masë sa të dëmtojnë thelbin e tyre dhe t'i privojnë nga efektiviteti; që ato të vendosen në ndjekje të një qëllimi legjitim; dhe që mjetet e përdorura të mos jenë të papërpjesëtuara. Në

veçanti, këto kushte nuk duhet të pengojnë “shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit”.

- Së pari, në vijueshmëri të argumenteve më sipër, u argumentua se të votuarit aktiv dhe pasiv është një instrument ligjor, që mbart të drejta dhe detyrime. Nëse si e drejtë është e qartë, duhet kuptuar se detyrimet që mbart variojnë, që nga detyrimi për të “sakrifikuar” nga koha për të ushtruar të drejtën, e deri tek nënshtrimi ndaj rregullimeve të tjera ligjore. Parashikimi i lehtësirave apo alternativave për votuesit janë një angazhim shoqëror, por jo të detyrueshme dhe të pandërlidhura me integritetin e procesit zgjedhor.
- Së dyti, të lejuarit dhe të mundësuarit e të votuarit të shtetasve jashtë vendit nuk duhet të jetë një vendim populist dhe një tjetër kryefjalë e procesit zgjedhor. Kujtojmë se në traditën e procesve zgjedhore ka patur gjithmonë një kryefjalë problematikë-zgjidhje, e cila është konsideruar zgjidhja fundore për integritetin e procesit zgjedhor. Megjithatë, këto zgjidhje “prej të rëne lapsi” nuk janë provuar si të tilla, por janë harruar në zgjedhjet pasardhëse. Kujtojmë që historiku i problematikë-zgjidhjeve të proceseve ka përfshirë në vijueshmëri temat si integriteti i lëshimit të certifikatave për votuesit, përgatitja dhe hartimi i listave të votimit, caktimi i zonës zgjedhore, procesi i numërimit, caktimi i anëtarëve të komisionit, përdorimi i teknologjisë së informacionit, apo ngritja e qeverisë teknike prag-zgjedhore. Nevojitet që mundësimi i votës nga jashtë mos të jetë një tjetër instrument zgjedhor jo i përdorur mirë.

[1] "... (5.1) – zgjedhje të lira që do të mbahen në intervale të arsyeshme me votim të fshehtë ose me një procedurë ekuivalente votimi të lirë, në kushte që sigurojnë në praktikë shprehjen e lirë të opinionit të votuesve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre;

[2] GJEDNJ, "Sitaropoulos e të tjerë kundër Greqisë", Aplikimi nr. 42202/07, Strasburg, 15 Mars 2012.

[3] GJEDNJ, "Shindler kundër Mbretërisë së Bashkuar", Aplikimi nr. 198401/09, Strasburg, 14 Dhjetor 2010.

[4] GJEDNJ, "Hilbe v. Litenshtein", Aplikimi nr. 31981/96, Strasburg, 7 Shtator 1999.

[5] GJEDNJ, "Melnychenko kundër Ukrainës", Aplikimi nr. 17707/02, Strasburg, 19 Tetor 2004.

[6] KEDNL, "Raporti për votimin jashtë vendit", Venecia, 16 Qershor 2011.

[7] Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, Rekomandimi 951 (1982), "E drejta për të votuar e shtetasve në Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës", 2 tetor 1982.

[8] KEDNL, "Raporti për votimin jashtë vendit", Venecia, 16 Qershor 2011.

[9] Revista Monitor, "Eurostat: Shqipëria mori 1.2 miliardë euro remitanca", 13 Dhjetor 2023.

[10] Vendimi i Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për komisionin qendror të zgjedhjeve", 6 Nëntor 2024.

[11] Sipas anketës së Komisionit European për Demokraci nëpërmjet Ligjit, "Votimi nga jashtë – Tabelë përmbledhëse", në vitin 2010 rezultojnë së paku 12 vende që nuk parashikojnë votimin nga jashtë. Këto ishin Shqipëria, Andora, Armenia, Kili, Qipro, Greqia, Irlanda, Izraeli, Malta, Maroku, Mali i Zi, San Marino, Turqia.

[12] International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA), "Unravelling Out-of-Country Voting".

[13] International Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA), "Unravelling Out-of-Country Voting".

[14] Komisioni European për Demokraci Nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), "Raporti për votimin jashtë vendit", miratuar nga Këshilli për Zgjedhjet Demokratike në takimin e 37-të, Venecia, datë 16 Qershor 2011.

[15] Shuji Yamauchi, "Comparing the Election Systems for Overseas Constituency Representatives in Multiple Countries", "Democracy, Politics and Innovation, and Social Integration in the Contemporary World", 14 Mars 2024.

[16] Guardian, "Fewer than 200,000 Britons living abroad apply to vote in UK election", 16 Qershor 2024.

[17] Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, "Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës", Aplikimi nr. 9267/81, Strasburg, 2 Mars 1987.